

VENDIM
Nr. 360, datë 29.4.2015

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM DHE
PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR PRODHIMIN, IMPORTIMIN, VENDOSJEN NË TREG
DHE PËRDORIMIN E TYRE¹**

(ndryshuar me vendimin nr. 691, datë 26.10.2022)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga ndotësit organikë të qëndrueshëm (NOQ), bazuar në parimin e parandalimit, nëpërmjet:

- a) ndalimit, nxjerrjes nga përdorimi të NOQ-ve ose kufizimit të prodhimit, vendosjes në treg dhe përdorimit sipas përcaktimeve të dhëna në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) reduktimit të shkarkimeve në mjedis të NOQ-ve deri në eliminimin e tyre;
- c) menaxhimit të mbetjeve që kanë në përbërjen e tyre ose që janë të kontaminuara me NOQ.

2. Ky vendim zbatohet për NOQ-të, që janë të listuar në Konventë dhe Protokoll, të referuar në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, janë:

- a) aneksi I, “Lista e substancave që janë objekt ndalimi”;
- b) aneksi II, “Lista e substancave që janë objekt i masave për reduktimin e shkarkimeve”;
- c) aneksi III, “Lista e substancave që janë objekt i masave të menaxhimit të mbetjeve”;
- d) aneksi IV, “Menaxhimi i mbetjeve”;
- e) aneksi V, “Formati i raportimit të stokeve”.

4. Për qëllime të këtij vendimi, të gjithë termat kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe në nenin 5, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Vendosje në treg” ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve.

b) “Artikull” ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

c) “Përzierje” ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

d) “Stok” janë substancat, përzierjet ose artikujt e grumbulluar nga mbajtësi i stokut që përbëhen ose përmbajnë ndonjë prej substancave të renditura në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi.

e) “Mbajtësi i stokut”, personi që zotëron, ruan, magazinon, siguron dhe kontrollon stokun.

dh) “Ndotës organikë të qëndrueshëm (NOQ)”, një komponim kimik organik i rrezikshëm, rezistent ndaj biodegradimit, duke mbetur në mjedis për një periudhë të gjatë kohe.

e) “Konventë”, konventa e Stokholmit “Për ndotësit organikë të qëndrueshëm”. Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Stokholmit me anë të ligjit nr. 9263, datë 29.7.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Stokholmit”.

ë) “Protokoll”, protokollin “Për ndotësit organikë të qëndrueshëm”, i konventës “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”, të ratifikuar nëpërmjet ligjit nr. 9425, datë 6.10.2005, “Për

¹ Ky vendim përaftron plotësisht rregulloren nr. 519/2012 që amendon rregulloren nr. 850/2004/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, “Për ndotësit organikë të qëndrueshëm”, datë 29 prill 2004, që amendon direktivën nr. 79/117/KEE, numri CELEX: 2004R085.

aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e vitit 1979, “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të madhe””.

f) “Import” ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve.

g) “Prodhim” ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

gj) “Përdorim” ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

h) “Substancë” ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

i) “Substancë e ndërmjetme në sisteme të mbyllura me sipërfaqe të kufizuara” është një substancë që prodhohet, konsumohet ose përdoret për përpunim kimik për t’u transformuar në një substancë tjetër (“sintezë”), ku prodhimi i substancës së ndërmjetme dhe sinteza e një ose më shumë substancave nga ajo substancë e ndërmjetme ndodh në të njëjtin vend, nga një ose më shumë subjekte, në kushte rreptësisht të kontrolluara, në mënyrë që të përmbahet në mënyrë rigorozë me mjete teknike gjatë të gjithë ciklit të jetës”.

j) “Ndotës gjurmë i paqëllimshëm” është niveli i një substance që gjendet rastësisht i pranishëm në një sasi minimale, e cila nëse gjendet nën këtë sasi minimale nuk mund të përdoret në mënyrë kuptimplotë dhe mbi limitet e gjurmimit të metodave ekzistuese të gjurmimit që mundësojnë kontrollin dhe zbatimin.

KREU II

KONTROLI I PRODHIMIT, VENDOSJA NË TREG DHE PËRDORIMI

Seksioni 1

Kontrolli i prodhimit, vendosja në treg, përdorimi, eksportimi dhe transitimi i NOQ-ve/mbetjeve të kontaminuara/që kanë në përbërje NOQ, si dhe kontrolli doganor

1. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet prodhimi, importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i NOQ-ve të referuara në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi, në formën e tyre të pastër, në përzierje ose si pjesë përbërëse e artikujve.

2. Referuar shkronjave “b”, “c” e “ç” të pikës 1, të seksionit 2, të këtij kreu, mbi bazën e përjashtimeve për përdorime të ndërmjetme ose specifikime të tjera të përcaktuara në pjesët “A” dhe “B”, të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi, ministri i Mjedisit autorizon importimin e NOQ-ve që ndodhen në substanca, përzierje ose si zëvendësues të pjesëve që gjenden në artikuj të caktuar, në përputhje me legjislacionin që rregullon importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme.

3. Autorizimi për importimin e NOQ-ve të referuara në shkronjat “b”, “c” e “ç”, të pikës 1, të seksionit 2, të këtij kreu, lëshohet vetëm nëse importuesi vërteton sasinë e NOQ-ve që ndodhet në substanca, përzierje ose si zëvendësues të pjesëve që gjenden në artikuj të caktuar, mbi bazën e certifikatës laboratorike, të lëshuar nga një laborator i akredituar në një nga vendet e BE-së.

4. Ministria njofton Sekretariatën e Konventës në rastin e dhënies së autorizimit të importit, referuar pikës 2, të seksionit 1, të këtij kreu.

5. Eksporti nga Republika e Shqipërisë drejt vendeve të tjera për NOQ-të, referuar shkronjave “b”, “c” e “ç” të pikës 1, të seksionit 2, të këtij kreu, për përdorime të ndërmjetme ose specifikime të tjera të përcaktuara në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi, lejohet vetëm për qëllime të asgjësimit të sigurt të tyre dhe/ose për përdorim të caktuar, të lejuar nga vendi importues.

6. Në rastin e eksportimit sipas pikës 3, të seksionit 1, të këtij kreu, eksportuesi pajiset me autorizim eksporti, në përputhje me legjislacionin që rregullon importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme.

7. Autorizimi për eksportimin e NOQ-ve lëshohet vetëm në rastet kur është dhënë pëlqimi eksplicit nga vendi importues.

8. Ministria njofton Sekretariatën e Konventës në rastin e dhënies së autorizimit për eksportin, sipas pikës 4, të seksionit 1, të këtij kreu.

9. Eksporti i mbetjeve që kanë në përbërje të tyre NOQ, të referuara në aneksin III, bashkëlidhur këtij vendimi, nga Republika e Shqipërisë drejt vendeve të tjera, lejohet vetëm për qëllime të asgjësimit të sigurt të tyre.

10. Eksportuesi i mbetjeve, sipas pikës 6, të seksionit 1, të këtij kreu, pajiset me autorizim për eksport,

në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbetjet e rrezikshme dhe marrëveshjet ndërkombëtare për këtë qëllim.

11. Ndalohet transiti i NOQ-ve të referuara në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi, ose i kimikateve të rrezikshme e pesticideve ekzistuese, që kanë në përbërje të tyre NOQ.

12. Ndalohet transiti i mbetjeve të rrezikshme që kanë në përbërje të tyre NOQ.

13. Referuar përcaktimeve të seksionit I, të këtij kreu, autoritetet doganore:

a) në zbatim të pikës 2, kontrollojnë pajisjen me autorizim për importin e NOQ-ve që ndodhen në substanca, përzierje ose si zëvendësues i pjesëve që gjenden në artikuj të caktuar, për raste specifike;

b) në zbatim të pikës 6, kontrollojnë pajisjen me autorizim për eksportin e NOQ-ve ekzistuese në treg ose të kimikateve dhe artikujve që kanë në përbërje të tyre NOQ;

c) në zbatim të pikës 10, kontrollojnë pajisjen me autorizim për eksportin e mbetjeve që kanë në përbërje të tyre NOQ.

14. Çdo datë 31 mars, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave raporton pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të dhënat e ruajtura të vitit të mëparshëm kalendarik për importin dhe eksportin e substancave, përzierjeve ose artikujve që përmbajnë NOQ, sipas listës së paraqitur në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të dhënat për eksportin e mbetjeve që kanë në përbërje të tyre NOQ. Të dhënat duhet të jenë individuale, sipas subjektit dhe ngarkesës.

15. Gjatë tremujorit të parë të çdo viti eksportuesi dhe importuesi raportojnë pranë ministria përgjegjëse për mjedisin sasitë e importuara dhe të eksportuara të substancave, përzierjeve ose artikujve që përmbajnë NOQ, sipas listës së paraqitur në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të dhënat për eksportin e mbetjeve që kanë në përbërje të tyre NOQ. Informacioni i raportuar përfshin një listë të emrave dhe adresave të çdo importuesi/eksportuesi, me të cilët është kryer import-eksporti.

Seksioni 2

Përfashtime nga masat e kontrollit

1. Masat e ndalimit, të parashikuara në pikën 1, të seksionit 1, të këtij kreu, nuk zbatohen:

a) për substancat që përdoren për kërkime në shkallë laboratorike ose si standard reference;

b) për substancën NOQ që gjendet si ndotës gjurmë, i paqëllimshëm, në përbërje të substancave, përzierjeve apo artikujve, i barabartë ose nën limitin e përcaktuar në aneksin 1, dhe kjo vërtetohet nga një laborator i akredituar ose në një laborator reference;

c) për substancat NOQ që ndodhen si pjesë përbërëse e artikujve, të cilët janë prodhuar përpara ose në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

ç) për substancat NOQ që ndodhen si pjesë përbërëse e artikujve, të cilët janë në përdorim përpara ose në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

d) në rastin e prodhimit ose të përdorimit të substancave NOQ si substanca të ndërmjetme në sisteme të mbyllura me sipërfaqe të kufizuar nga operatorët e impianteve industriale.

dh) për qëllime të shkronjës “e”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit dhe bazuar në kufizimet në kohë të përcaktuara në pjesën A, të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi, lejon zhvillimin e aktivitetit industrial në rastet kur:

i) sipas pjesës A, të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi, shprehet specifikisht se substanca NOQ në fjalë mund të lejohet të prodhohet dhe të përdoret për qëllimin e kërkuar;

ii) gjatë procesit të prodhimit, substanca NOQ do të transformohet në një ose më shumë substanca të tjera që nuk shfaqin karakteristikat e NOQ-ve;

iii) prodhimi dhe përdorimi i kësaj substance nuk ndikon e nuk ka efekte në shëndetin e njerëzve dhe në mjedis, e vërtetuar kjo nëpërmjet vlerësimit që i bëhet sistemit të mbyllur, në përputhje me legjislacionin mbi klasifikimin, paketimin, etiketimin dhe rregullat për ruajtjen e substancave dhe të përzierjeve të rrezikshme.

2. Ministria njofton Sekretariatit e Konventës në rastin e dhënies së lejes së mjedisit për operatorin industrial. Njoftimi, në këtë rast, përmban, gjithashtu, informacionin e detajuar për:

a) prodhimin aktual apo të përgjithshëm të vlerësuar;

b) përdorimin e substancës NOQ në fjalë;

c) natyrën e procesit me sistem të mbyllur me sipërfaqe të kufizuar, ku specifikohet sasia e

patransformuar e çdo substance NOQ dhe sasia gjurmë e NOQ-ve në produktin final, për shkak të kontaminimit të paqëllimshëm të materialit fillestar gjatë procesit teknologjik.

KREU III MENAXHIMI I SHKARKIMEVE TË NOQ-ve NË MJEDIS

Seksioni 1

Stoqet

1. Personat fizikë ose juridikë që mbajnë stoqe, vlerësojnë nëse këto stoqe përbëhen ose përmbajnë NOQ, sipas aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi kryhet nga një laborator i akredituar ose një laborator reference. Sasitë e identifikuar të stoqeve dhe përmbajtja sasiore në to e substancave NOQ, të referuara në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi, raportohen pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM).

2. AKM-ja, mbi bazën e raportimit, kryen verifikimin në vend të sasive të raportuara dhe vlerëson nëse stoku i identifikuar mund të lejohet të përdoret ose jo, në përputhje me kufizimet e përcaktuara në pjesën A, të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Stoqet, për të cilat AKM-ja nuk lejon përdorimin, konsiderohen si mbetje të rrezikshme dhe mbajtësi i tyre merr masat për asgjësimin e tyre përfundimtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme.

4. Në rastin kur AKM-ja lejon përdorimin e stokut, mbajtësi i stokut, kur sasia e NOQ-ve kundrejt sasisë totale të stokut është më shumë se 50 kg, raporton çdo vit pranë AKM-së, lidhur me:

- a) natyrën dhe përmbajtjen e stokut;
- b) identitetin e substancave NOQ;
- c) sasinë e tyre, vendndodhjen e stokut;
- ç) kushtet e ruajtjes;
- d) të dhëna të hollësishme për qëllimin e përdorimit për të cilin është lejuar përdorimi.

Detyrimi për raportim fillon një vit pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në përputhje me kufizimet kohore të përdorimit, të përcaktuara në pjesën A, të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Mbajtësi i stoqeve kryen raportimin e përcaktuar në pikat 1 dhe 4, të seksionit 1, të këtij kreu, sipas formatit për raportimin e stoqeve të paraqitur në aneksin V, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Mbajtësi i stoqeve merr masat për menaxhimin e sigurt dhe eficient të stoqeve.

7. Mbajtësi i stokut, pas mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në pjesën A, të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi, merr masa për asgjësimin përfundimtar të stokut, në përputhje me legjislacionin përkatës për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme. Gjithashtu, siguron, pastrimin e zonës së ndodhjes së stokut dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme.

Seksioni 2

Menaxhimi i mbetjeve

1. Krijuesit dhe mbajtësit e mbetjeve kanë detyrim të marrin masat për të shmangur kontaminimin e mbetjeve të tyre me substancat e referuara në aneksin III, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Për mbetjet e identifikuar që përbëhen nga, apo që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të referuara në aneksin III, bashkëlidhur këtij vendimi, krijuesit dhe mbajtësit e mbetjeve rikuperojnë ose asgjësojnë mbetjet në përputhje me operacionet e trajtimit, të parashikuara në pjesën 1, të aneksit IV, bashkëlidhur këtij vendimi, duke siguruar që:

a) substanca NOQ është shkatërruar në mënyrë përfundimtare ose është transformuar në mënyrë të pakthyeshme;

b) mbetjet e mbetura dhe shkarkimet e çliruara gjatë këtij procesi nuk shfaqin veti ose karakteristika të NOQ-ve.

Gjatë kryerjes së proceseve të asgjësimit ose rikuperimit, çdo substancë e veçuar nga mbetjet dhe që u përket substancave të referuara në aneksin III, bashkëlidhur këtij vendimi, asgjësohet në mënyrë përfundimtare ose transformohet në mënyrë të pakthyeshme.

3. Në Republikën e Shqipërisë ndalohen operacionet e asgjësimit ose të rikuperimit që mund të çojnë në rikuperimin, riciklimin ose ripërdorimin e substancave të referuara në aneksin III, bashkëlidhur këtij

vendimi.

4. Përjashtohen nga kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të seksionit 2, të këtij kreu, rastet e mëposhtme:

a) Kur mbetjet mund të asgjësohen ose të rikupërohen me metoda të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbetjet e rrezikshme, me kusht që përqendrimi i substancave të përmendura në aneksin III, bashkëlidhur këtij vendimi, në mbetje, pas trajtimit të tyre, të jetë nën limitet e përqendrimit, të specifikuar në këtë aneks.

b) Kur dekontaminimi i mbetjeve, shkatërrimi në mënyrë përfundimtare ose transformimi në mënyrë të pakthyeshme i substancës NOQ, të listuar në aneksin III, përqendrimi i së cilës është sa vlera e përcaktuar në pjesën 2, të aneksit IV, nuk është i mundur të kryhet duke përdorur operacionet e trajtimit të parashikuara në pjesën 1, të aneksit IV ose duke përdorur operacione të tjera, në përputhje me praktikën më të mira mjedisore apo teknikat më të mira të disponueshme. Në këtë rast, Agjencia Kombëtare e Mjedisit autorizon krijuesin ose mbajtësin e mbetjeve të përdorë operacionet alternative të përcaktuara në pjesën 2, të aneksit IV, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbetjet e rrezikshme.

c) Në rastin e përmendur në shkronjën "b", nga operacionet e asgjësimit të specifikuar në pjesën 2, të aneksit IV, ruajtja e përherëshme kryhet në një nga vendet e mëposhtme:

- i) në formacione të forta shkëmbore, nën-tokësore, të thella dhe të shkurta;
- ii) në miniera të kripës;
- iii) në lëndë të mbetjeve të rrezikshme.

Seksioni 3

Reduktimi, minimizimi dhe eliminimi i shkarkimeve

1. AKM-ja krijon dhe mirëmban inventarin e shkarkimeve në ajër, në ujë, dhe në tokë për substancat e përmendura në aneksin II, bashkëlidhur, në përputhje me kërkesat e Konventës dhe të Protokollit. Raportimi në AKM nga institucionet përgjegjëse dhe operatorët industrialë, për qëllime të krijimit të inventarit, bëhet në përputhje me legjislacionin që rregullon krijimin e regjistrit kombëtar të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve.

2. Bazuar në rezultatet e inventarit, ministria përgjegjëse, në bashkëpunim me institucionet e linjës, përgatit planin e veprimit me masat që duhen ndërmarrë për identifikimin, karakterizimin, minimizimin dhe eliminimin e shkarkimeve totale të NOQ-ve. Plani i veprimit përfshin, gjithashtu, masa që nxitin përdorimin e materialeve, produkteve dhe proceseve teknologjike që parandalojnë formimin dhe çlirimin e substancave të referuara në aneksin II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Gjatë shqyrtimit të lejes mjedisore për impiantet industriale, të reja ose ekzistuese, që përdorin procese që çlirojnë substanca të referuara në aneksin II, bashkëlidhur, AKM-ja merr në konsideratë proceset, teknikat ose praktikën alternative, që minimizojnë formimin dhe çlirimin e këtyre substancave, përveç kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit".

4. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, AKM-ja harton programin vjetor të monitorimit në mjedis të dioksinave, furaneve dhe bifenileve të poliklorinuara (PCB), në përputhje me listën e paraqitur në aneksin II, bashkëlidhur. Ky program do të jetë pjesë e programit vjetor të monitorimit të gjendjes në mjedis.

Seksioni 4

Plani kombëtar i veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e NOQ-ve

1. Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, dhe legjislacionit në fuqi për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin, ministria përgjegjëse për mjedisin përgatit planin kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e NOQ-ve.

2. Ministria ia komunikon planin e miratuar Sekretariatit të Konventës.

Seksioni 5

Raportimet

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) krijon, administron dhe përditëson një *database* për importin, vendosjen në treg dhe përdorimin e NOQ-ve, qoftë në formë të substancës së pastër, në përzierje ose si pjesë përbërëse e artikujve, bazuar në informacionin e raportuar në pikat 2 dhe 4, të seksionit 1, dhe në

pikën 2, të seksionit 2, të kreut II, të këtij vendimi.

2. AKM-ja, në zbatim të këtij vendimi, përgatit çdo vit raportin me të dhënat e mëposhtme:

a) Informacionin e marrë nga mbajtësit e stokeve, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu;

b) Një informacion përmbledhës lidhur me inventarët e shkarkimeve, të hartuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të seksionit 3, të këtij kreu;

c) Informacion për prezencën e dioksinave, furaneve dhe bifenileve të poliklorinuara (PCB), në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 4, të seksionit 3, të këtij kreu.

3. Ministria, çdo 4 vjet, raporton pranë Sekretariatit të Konventës informacionin e përmbledhur me të dhënat e referuara në pikat 1 dhe 2, të seksionit 5, të këtij kreu.

KREU IV INSPEKTIMI

1. Në zbatim të kërkesave të këtij vendimi, ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit janë autoriteti kompetent që bashkërendon punën midis institucioneve përgjegjëse të specifikuara në pikën 2, të këtij kreu.

2. Për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi, autoritetet e inspektimit janë:

a) Struktura përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin në fushën e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mjedisin (ajrin, mbetjet dhe kimiketet);

b) Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, në përputhje me rregullat që rregullojnë fushëveprimin dhe autoritetin e inspektimit sanitar;

c) Inspektorati (fitosanitar) në përputhje me rregullat që rregullojnë fushëveprimin dhe kompetencat e inspektimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;

ç) Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, në ministrinë përgjegjëse për tregtinë, në përputhje me rregullat që rregullojnë fushëveprimin dhe kompetencat e tij për të monitoruar vendosjen në treg dhe mbikëqyrjen e kimikateve të rrezikshme.

KREU V KUNDËRVAJTJET

1. Mospërmbushja e kërkesave të këtij vendimi përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas shkronjës “ç”, të nenit 69, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, për veprimet/mosveprimet, në rastet e:

a) prodhimit, importimit, vendosjes në treg dhe përdorimit të NOQ-ve në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të seksionit I, të kreut II, të këtij vendimi;

b) eksportit të NOQ-ve në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikat 5, 6, dhe 7, të seksionit I, të kreut II, të këtij vendimi;

c) eksportit të mbetjeve të kontaminuara me NOQ në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikat 9 dhe 10, të seksionit I, të kreut II, të këtij vendimi;

ç) transitit të NOQ-ve dhe mbetjeve që kanë në përbërje NOQ, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikat 11 dhe 12, të seksionit I, të kreut II, të këtij vendimi;

d) mosvënies në dispozicion të ministria përgjegjëse për mjedisin të të dhënave të përcaktuara në pikën 15, të seksionit I, të kreut II, të këtij vendimi;

dh) mosvënies në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të të dhënave për stoqet, të përcaktuara në pikat 1 dhe 5, të seksionit 1, të kreut III, të këtij vendimi.

e) mosmenaxhimit të sigurt dhe eficient të stokeve deri në asgjësimin përfundimtar të tyre nga mbajtësi i stokeve, sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 6 dhe 7, të seksionit 1, të kreut III, të këtij vendimi.

2. Mospërmbushja e kërkesave të këtij vendimi përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas pikës 26, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, për veprimet/mosveprimet, në rastet e:

a) mosmarrjes së masave nga krijuesit dhe mbajtësit e mbetjeve për të shmangur kontaminimin e tyre, sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 1, të seksionit 2, të kreut III, të këtij vendimi;

b) mosmarrjes së masave nga krijuesit dhe mbajtësit e mbetjeve për rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2, të seksionit 2, të kreut III, të këtij vendimi;

c) kryerjes së operacioneve të asgjësimit ose të rikuperimit që mund të çojnë në rikuperimin, riciklimin ose ripërdorimin e substancave të referuara në aneksin III, bashkëlidhur këtij vendimi, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 3, të seksionit 2, të kreut III, të këtij vendimi.

KREU VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, struktura përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin në fushën e mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe institucionet përgjegjëse të linjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI I
(ndryshuar me vendimin nr. 691, datë 26.10.2022)

PJESA A
SUBSTANCAT E LISTUARA NË KONVENTË DHE NË PROTOKOLL, SI DHE
SUBSTANCAT E LISTUARA VETËM NË KONVENTË

Nr. rendor	Emri i substancës	Nr. CAS	Kodi tarifar sipas NK së mallrave	Nr. KE	Përjashtime specifike për përdorim të ndërmjetëm ose specifikime të tjera
1.	1 Eteri i Tetrabromodifenilit (Tetrabromodiphenyl ether) C ₁₂ H ₆ Br ₄ O	40088-47-9 dhe të tjera	2909 30 38	254-787-2 dhe të tjera	1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimit e eterit të tetrabromodifenilit, që është i barabartë me ose nën 10 mg/kg (0,001 % të peshës), kur është i pranishëm në substanca. 2. Për qëllime të hyrjes së substancave tetra-, penta-, hekza-, hepta- dhe dekabromodifenil, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimit e këtyre substancave deri në 500 mg/kg, që ndodhen në përzierje ose artikuj. 3. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara datës 1 korrik 2015, të cilat përmbajnë eter tetrabromodifenili në përbërje.
2.	2 Eteri i Pentabromodifenilit (Pentabromodiphenyl ether) C ₁₂ H ₅ Br ₅ O	32534-81-9 dhe të tjera	2909 30 31	251-084-2 dhe të tjera	1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimit e eterit të pentabromodifenilit, që është i barabartë me ose nën 10 mg/kg (0,001 % të peshës), kur ndodhet në substanca. 2. Për qëllime të hyrjes së substancave tetra-, penta-, hekza-, hepta- dhe dekabromodifenil, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimit e këtyre substancave deri në 500 mg/kg, që ndodhen në përzierje ose artikuj. 3. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara datës 1 korrik 2015, të cilat kanë eter pentabromodifenili në përbërje.
3	Eteri i Hekzabromodifenilit (Hexabromodiphenyl ether) C ₁₂ H ₄ Br ₆ O	36483-60-0 dhe të tjera	2909 30 38	253-058-6 dhe të tjera	1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimit e eterit të hegzabromodifenilit, që është i barabartë me ose nën 10 mg/kg (0,001% të peshës), kur është i pranishëm në substanca. 2. Për qëllime të hyrjes së substancave tetra-, penta-, hekza-, hepta- dhe decaBDE, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për masën e përqendrimit të këtyre substancave deri në 500 mg/kg, që ndodhen në përzierje ose në artikuj. 3. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara datës 1 korrik 2015, të cilat kanë eter hegzabromodifenili në përbërje.
4	Eteri i Heptabromodifenilit (Heptabromodiphenyl ether)	68928-80-3 dhe të tjera	2909 30 38	273-031-2 dhe të tjera	1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimit e

	C ₁₂ H ₃ Br ₇ O				eterit të heptabromodifenilit, që është i barabartë me ose nën 10 mg/kg (0,001% të peshës), kur ndodhet në substanca. 2. Për qëllime të hyrjes së substancave tetra-, penta-, hekza-, hepta- dhe decaBDE, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për masën e përqendrimit të këtyre substancave deri në 500 mg/kg, që ndodhen në përzierje ose në artikuj. 3. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara datës 1 korrik 2015, të cilat kanë eter heptabromodifenili në përbërje.
5	Eter bis(pentabromofenili) eter (dekabromodifenili; decaBDE) <i>(Bis(pentabromophenyl) ether (decabromodiphenyl ether; decaBDE))</i>	1163-19-5	2909 30 38	214-604-9	1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për <u>përqendrimit e decaBDE, që janë të barabarta me ose nën 10 mg/kg (0,001 % të peshës)</u>, kur ndodhet në substanca. 1. 2. Për qëllime të hyrjes së substancave tetra-, penta-, hekza-, hepta- dhe decaBDE, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për masën e përqendrimit të këtyre substancave deri në 500 mg/kg, që ndodhen në përzierje ose në artikuj; 3. Si përjashtim, lejohet prodhimi, vendosja në treg dhe përdorimi i decaBDE për qëllimet e mëposhtme dhe në përputhje me parashikimet e Konventës: a) në prodhimin e një mjeti ajror, për të cilin miratimi i tipit është kërkuar përpara datës 2 mars 2019 dhe është marrë përpara dhjetorit të vitit 2022, deri më 18 dhjetor 2023 ose, në rastet kur arsyetohet nevoja për shtyrje, deri më 2 mars 2027; b) në prodhimin e pjesëve të këmbimit për: i. një mjet ajror, për të cilin miratimi i tipit është kërkuar përpara datës 2 mars 2019 dhe është marrë përpara dhjetorit të vitit 2022, prodhuar përpara datës 18 dhjetor 2023 ose, në rastet kur arsyetohet nevoja për shtyrje, prodhuar përpara datës 2 mars 2027, deri në përfundim të kohëzgjatjes së shërbimit të atij mjeti ajror; ii) mjete motorike që janë objekt i udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin nr. 11, datë 30.5.2011, “Për miratimin e mjeteve motorike dhe rimorkiot e tyre dhe sistemet e komponentëve dhe njësitë e këmbyeshme të parashikuar për këto mjete”, prodhuar përpara datës 15 korrik 2019, ose deri në vitin 2036 apo deri në përfundim të kohëzgjatjes së shërbimit të këtyre mjeteve motorike, cilado datë që vjen e para; 4. Përjashtimet specifike për pjesët e këmbimit të mjeteve motorike referuar në pikën 3(b)(ii) me sipër, zbatohen për prodhimin dhe përdorimin e decaBDE, që përkon me një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtme: a) sistem transmissiion dhe lidhje nën kofanon e mjetit, siç janë përcjellësit e baterisë, kabllot ndërlidhëse të baterisë, tubat e lëvizshëm të ajrit të kondicionuar (MAC), sistemet e transmissiionit, unazat e tubave të shkarkimit, izolimi nën kofano, lidhjet elektrike dhe rripat nën kofano (lidhjet elektrike në motor etj.), sensorët e shpejtësisë, zorra, njësi ventilimi dhe

					sensorët e trokitjes; b) aplikimet në sistemin e karburantit, siç janë tubat, serbatorët dhe serbatorët e karburantit nën trupin e mjetit; c) pajisje piroteknike dhe aplikime të ndikuara nga pajisje piroteknike, siç janë jastëku i ajrit, kabllot e ndezjes, mbulesat/veshjet e ndenjësive (vetëm nëse janë të përshtatshme për jastëkun e ajrit) dhe jastëkët e ajrit (të përparmë dhe të pasmë).
					5. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të cilat kanë decaBDE në përbërje. 6. Pa cenuar zbatimin e parashikimeve të tjera të legjislacioneve që rregullojnë klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, artikujt në të cilët përdoren decaBDE do të identifikohen nëpërmjet etiketimit ose mënyrave të tjera gjatë ciklit të tyre të jetës. 7. Lejohet vendosja në treg dhe përdorimi i artikujve që përmbajnë decaBDE, të importuar për qëllime të përjashtimeve specifike në pikën 3, me sipër, deri në datën e mbarimit të përjashtimit. Pika 6, zbatohet sikur këta artikuj të ishin prodhuar në përputhje me përjashtimin në pikën 3. Artikuj të tillë që janë në përdorim deri në datën e mbarimit të përjashtimit përkatës mund të vazhdojnë të përdoren. 8. Për qëllime të kësaj hyrjeje, “mjet ajror” nënkupton si më poshtë: a) mjet ajror civil i prodhuar në përputhje me certifikatën e tipit të lëshuar sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin nr. 3, datë 7.2.2011, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, ose me miratimin e projektimit të lëshuar sipas rregulloreve kombëtare të një shteti nënkontraktues të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil ((ICAO), ose për të cilin është lëshuar një certifikatë e vlefshmërisë ajrore nga një Shtet Kontraktues i ICAO-s, sipas aneksit 8 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar; b) mjet ajror ushtarak.
6	Acidi sulfonik i perfluorooktanit dhe derivatët e vet (PFOS) <i>(Perfluorooctane sulfonic acid and its derivatives (PFOS))</i> C8F17SO2X (X = OH, kripëra metalike (O-M+), halide, amide, dhe derivate të tjera, duke përfshirë polimeret)	1763-23-1 2795-39-3 29457-72-5 29081-56-9 70225-14-8 56773-42-	2909 30 38 2904 34 00 2904 32 00 2922 16 00 2923 30 00	217-179-8 220-527-1 249-644-6 249-415-0 274-460-8 260-375-3 223-980-3 250-665-8 216-887-4 246-262-1	1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për <u>përqendrimet e PFOS-së, që janë të barabarta me ose nën 10 mg/kg (0,001 % të peshës)</u>, kur ndodhet në substanca ose në përzierje. 2. Për qëllime të kësaj hyrjeje, shkronja “b”, e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për <u>përqendrimet e PFOS-së në produkte ose artikuj gjysmë të gatshëm</u>, ose

